



Në mbështetje të nenit 14 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1., nenit 15, nenit 48 paragrafi 2, nënparagrafi b), d), e) dhe nenit 49 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2. të Rregullores Disiplinore të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), Komisioni Disiplinor i FBK-së, pas zhvillimit të procedurës disiplinore mori këtë

V E N D I M

- I. Blerand Stavileci, kryetar i Klubit të Basketbollit Sigal Prishtina, për shkelje të lehtë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: "Vërejtje".
- II. Luan Maloku, nënkryetar i Klubit të Basketbollit Sigal Prishtina, për shkelje të lehtë disiplinore, i shqiptohet masa disiplinore: "Vërejtje".
- III. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit.

A R S Y E T I M

Komisioni Disiplinor (këtu e tutje Komisioni) nëpërmjet postës elektronike, më datën 31.03.2024, ka pranuar email nga sekretarja e përgjithshme, znj. Elvira Dushku, në të cilin ka gjetur të bashkëngjitur kërkesën e z. Artan Gashi, kryetar i Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës (SHGJFBK) për inicimin e procedurës disiplinore, ndaj z. Blerand Stavileci, kryetar i KB Sigal Prishtina dhe Luan Maloku, nënkryetar i KB Sigal Prishtina, nën arsyetimin se pas përfundimit të ndeshjes së gjysmëfinale ndërmjet KB Trepça dhe KB Sigal Prishtina, e zhvilluar në kuadër të Final 8 të Ligës Unike, më datën 29.03.2024, në Vlorë, të njëjtit kanë sharë dhe ofenduar si dhe kanë shkuar deri në kërcënime e kacafytje me gjyqtaret e ndeshjes: Xhelal Mumini, Gilbert Hoxha dhe Elldin Uglari.

Ashtu siç përcaktohet me aktet në fuqi, Komisioni, më qëllim që menjëherë të filloj me shqyrtimin e fakteve dhe provave në procedurën disiplinore, me datën 02.04.2024, në orën 16.30, në lokalet e FBK-së, ka mbajtur takimin e parë shqyrtues, me ç 'rast ka dizajnuar administrimin e procesit për të vlerësuar faktet dhe rrethanat e ngjarjes që janë të nevojshme për marrjen e vendimit. Në kuadër të këtij takimi, Komisioni, në përbërje të plotë dhe aprovim nga të gjithë anëtarët vendosi që për qëllime të verifikimit të fakteve dhe në zbatim të drejtë të Rregullores Disiplinore të FBK-

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsors:



BIP PARASUŠI ZINIVERTI

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:





së, duke zbatuar nenin 38 të Rregullores Disiplinore, nëpërmjet shërbimeve të sekretarisë të FBK-së, për t'u njohur me variantin e ngjarjes apo të problemit, palëve të përfshira në konflikt t'u kërkohet që të deklarohen më shkrim.

Në funksion të trajtimit të lëndës, përveç takimit të datës 02.04.2024, Komisioni është takuar edhe më datën 08.04.2024, 22.04.2024 dhe datën 26.04.2024. Në takime kanë qenë prezent: Fidan Hamiti – kryetar (prezent në të gjitha takimet), Afrim Kamishi – anëtar (prezent në të gjitha takimet, dy nga të cilat “online”), Omer Daku – anëtar (prezent në të gjitha takimet) si dhe në përputhshmëri me nenin 36 të Rregullores Disiplinore, prezent kanë qenë edhe zyrtarë të FBK-së, Elvira Dushku, sekretare e përgjithshme e FBK-së, respektivisht Adriatik Rraci, zëvendëssekretar i FBK-së dhe Enea Hajdari, këshilltare ligjore për sport e FBK-së.

Më datën 05.04.2024, Komisioni, nëpërmjet email-it, nga shërbimet e sekretarisë të FBK-së, sipas kërkesës, nga palët si në vijim ka pranuar tetë (8) deklarata të ndara, respektivisht gjashtë (6):

1. Artan Gashi, kryetar i SHGJFBK,
2. Elldin Uglari, gjyqtar i ndeshjes,
3. Gibert Hoxha, gjyqtar i ndeshjes,
4. Izet Tahiri, zyrtar i KB Trepça,
5. Xhelal Mumini, gjyqtar i ndeshjes dhe
6. Ngadhnjim Shabani, gjyqtar në FBK.

Dhe, dy (2) të tjera nga palët ndaj të cilave është iniciuar procedurë disiplinore të cilat fillimisht kanë kërkuar që (teksti pa ndërhyrje): *“1. Të rishikohet kompetenca e Komisionit në kuptim të Nenit 1, paragrafi 1.6, dhe Nenit 11 të Rregullores së Garave të Ligës Unike - Edicioni 2024, dhe 2. Pasi që në mënyrë definitive të zgjidhet kompetenca lëndore e Komisionit Disiplinor të FBK-së, kërkoj që para deklarimit tim, të më dërgohen të gjitha deklaratat të cilat kanë shërbyer si bazë për iniciimin e procedurës disiplinore”.*

Për t'ua sqaruar dilemat e ngritura, sekretarja e përgjithshme e FBK, znj. Elvira Dushku, sipas detyrës zyrtare të përcaktuara me aktet përkatëse, më datën 09.04.2024, nëpërmjet email-it, duke ua bashkëngjitur kërkesën për iniciim të procedurës disiplinore dhe deklaratat e të përfshirëve dhe dëshmitarëve për rastin që ka ndodhur, më 29 mars, pas ndeshjes së dytë gjysmëfinale, në kuadër të Final 8 - Liga Unike, Meshkujt, e zhvilluar në mes KB Sigal Prishtinës dhe KB Trepçës, ua ka konfirmuar

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





z, Stavileci dhe z. Malokut se Komisioni Disiplinor i FBK-së ka autoritet të plotë për të trajtuar inicimin e procedurës disiplinore. Dhe, si përfundim në kuadër të këtij email-i ua ka përsëritur nevojën, gjegjësisht kërkesën për deponim të deklaratës me shkrim, sipas kërkesës së Komisionit Disiplinor. Më datën 16.04.2024, nga z. Stavileci dhe z. Maloku, Komisioni ka pranuar dy shkresa të ndara por me përmbajtte të njëjtë, ku ndër të tjera thuhet (teksti pa ndërhyrje): *"Lidhur me kërkesen e Komisionit Disiplinor per dhenien e nje deklarate me shkrim, ne mendojme se menyra me e mire per te vazhduar me procedimin e kesaj ceshtje, eshte caktimi i nje seance disiplinore. Rrjedhimisht, kerkojme qe te organizohet nje seance disiplinore bazuar ne nenin 36 paragrafeve 1 dhe 2 te Rregullores Disiplinore, ku duhet te marrin pjese te gjitha palet e perfshira. Per shkak te kesaj kerkese, ne do presim dhe nuk do dergojme deklarate me shkrim deri ne nje pergjigje tuajen"*.

Përkundër mospërputhjes së kërkesës së tyre me dispozitat e Rregullores Disiplinore, në frymën afirmative, Komisioni në mbledhje e datës 22.04.2024, mori vendim që palëve ndaj të cilave është iniciuar procedurë disiplinore, t'ju jepet mundësia e fundit për dhënie të deklaratave (me shkrim ose me gojë), në formë që ata do të ndiheshin të trajtuar.

Më datën 26.04.2024, nga z. Stavileci dhe z. Maloku, nëpërmjet email-it, Komisioni ka pranuar deklarata me shkrim të ndara, po përmbajtësisht të njëjta, ku ndër të tjera ka shkëputur tekstin pa ndërhyrje të një pjese të z. Blerand Staileci: *"Vendimet e padrejta dhe të gabuara që reflektuan edhe në pjesën e dytë (*tendencioziteti le të mbetet në ndërgjegjen e gjyqtarit shkaktar) normalisht që ndikuan në epilogun final dhe kjo shkaktoi nervozë tek i gjithë stafi. Me të dalë nga salla paraprakisht përsëri duke e qarë këtë hall edhe me Komisararin, i cili përsëri i pohoi gabimet e shumta, duke më thënë se "as mua s'po më pëlqen kur po gabojnë", u takuam me shumë zyrtarë në hyrje të objektit. I vetmi gjyqtar që u largua pa na përshëndetur ishte Eldin Uglari, figura tensionnxitëse e asaj ndeshjeje. Duke i ditur faktet dhe duke e ditur historinë e tendenciozitetit të tij dhe gabimeve të shumta që i ka bërë në të kaluarën, ia dhashë etiketën e kriminelit dhe hajnit sportiv, sepse konsideroj që secili që bën këso dëmsh sportive meriton ta ketë këtë etiketë, e sidomos ata që për obligim e kanë ndarjen e drejtësisë. Në vazhdim e mallkova me fjalët: "Ta ktheftë Zoti atë që ti na e bëre neve!" Në atë moment e kam parë duke u vërsulë ndaj nesh dhe e di që zyrtarë të shumtë kanë reaguar, përsëri me fjalë, e njëri prej tyre normalisht në mbrojtje timen, Nënkrjetari Maloku"*.

Nder të tjera, Komisioni ka shkëputur edhe pjesë të deklaratës së z. Luan Maloku, ku përveç tjerash thuhet (teksti pa ndërhyrje): *Në vazhdim Presidenti Stavileci e mallkoi*

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





me fjalët: "Ta ktheftë Zoti atë që ti na e bëre neve!" "Në atë moment e kam parë duke u vërsulë ndaj nesh dhe e di që zyrtarë të shumtë kanë reaguar, përsëri me fjalë, e njëri prej tyre normalisht në mbrojtje e Presidentit Stavileci, isha edhe unë. Në ato momente e kam lutur Xhelal Muminin që të vazhdoj sepse cdo të dytën fjalë thoshte spo ju tutet kerkush dhe me kujtohet që Elldini thojke veç qele deren me hi ne kerr dhe nje moment e kom pa Elldinin që është versulur dhe menxi e kan ndalur referet tjere per te mos ndodhur diqka dhe unë nga larg i thash fjalët "që je kaq trim se pasna dite po ska problem se tash vi ne hotel e te rrehi". Pra të gjitha fjalët dhe reagimet kanë qenë normale siç ndodhë gjithmonë kur ka tensione mes palëve e sidomos kur ato shkaktohen nga ata që nuk gjykojnë drejtë dhe mirë, për çka janë të obliguar dhe paguhen".

Më qëllim që ta ruaj paanësinë dhe ta vlerësoj situatën në mënyrë sa më objektive, Komisioni ka analizuar edhe deklaratat e palëve të tjera, përfshirë këtu atë të iniciuesit, gjyqtarëve dhe dëshmitarëve të tjerë të cilët afërsisht konfirmojnë të njëjtin fakt, me c'rast ka shkëputur pjesë si vijon (teksti pa ndërhyrje):

Në deklaratën e tij z. Artan Gashi, kryetar i i SHGJFBK, ka theksuar se (teksti pa ndërhyrje): "Me datën 29.03.2024 në kuader të FINAL 8 të Liges Unike e mbajtur në qytetin e Vlores, pas perfundimit të ndeshjes së gjysmë finale në mes të Kb.Trepca vs Kb.Sigal Prishtines me të dalur jashtë palestres treshja e gjyqtareve në krye me Xhelal Muminin, Gilbert Hoxhes dhe Elldin Uglari, ofendohen nga ofendimet dhe sharjet me të renda, ku dhe atakohen tentohen të sulmohen nga presidenti i Sigal Prishtines Blerand Stavileci dhe Luan Maloku, ky i fundit madje kercenon gjyqtarin Elldin Uglarin duke i then "oo Elldin Uglari pasha familjen ko met rreh nje dite po kur se di! A te rrehi sot ne hotel a ku nuk e di" pasi që ishim të vendosur po ne të njëjtin hotel. Fatmiresisht ishim afër dhe me nderhyrjen time (Artan Gashi) dhe Ngadhnjim Shabani si dhe shume antareve të klubeve të Kb.Trepca - Kb.Peja dhe Kb.Ylli evitohet ndonje sulem fizik ose ndonje rahje masive".

Gjyqtari Elldin Uglari në deklaratën e tij të deponuar ka theksuar (teksti pa ndërhyrje): "Me të perfunduar ndeshja pas daljes tone nga palestra zyrtaret e KB Sigal Prishtina ishin duke na pritur jashtë mu dhe koleget e ndeshjes për të na ofenduar dhe kercenuar me pretendimet e tyre për ndeshjen. Dua të jem i shkurt dhe i kjarë ne ket deklaret timen pasi që vetem tash që po me kujtohet sitata që kam perjetuar po ndihem jo mire. Zyrtaret Blerand Stavileci dhe Luan Maloku me kan ofendaur dhe kercenuar me fajlet me ofenduse dhe me kercenuse që kam perjetuar në karieren time 11 vjeqare si refer i basketbollit. Ne prani të shum njerezve që i perkasin komunitetit të basketbollit. Duke me thene fjalet me të renda dhe me kercenuse që kam ndegjaur ndonje here ne jeten

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





time . Kjo qe ka ndodhur eshte skandali me i madh qe kam perjetuar dhe kerkoj denimin e merituar per personat ne fjale”.

Në deklaratën e tij, z. Gilbert Hoxha, gjyqtar i ndeshjes, ndër të tjera theksuar (teksti pa ndërhyrje): *“Pas perfundimit te ndeshjes se lartpermendur ne ambjentet e jashtme (te hyrjes se pallatit te sportit) u provokuam nga dy persona ge une personalisht nuk Injihja por u vura ne dijeni dhe nga koleget e mi qe me sprehen se jane zyrtare te KB SIGAL PRISTINA, ne drejtimin tone por me se shumti drejt givgtarit ELLDIN ULLGARI. Une po citoj disa nga fjalet qe arrita te kuptoj (ndjese por dhe per shkak te akcentit nuk arrita ti kuptoj te gjitha) por ato ge arrita te deshifroj ishin: EL kriminelo, Hajd se do e referosh me ekipin tone, Djal Pis" dhe une giate giithe kohes kam gendruar ne krahun e ELLINIT per ta qetesuar qe mos te acarohet dhe kunderpergjiigie ne distance nga zyrtaret per te ruaitur getesine ge nevojitej. Kolegu tjetër Xhelal Mumini qe ne fillim te ketij debati te ashper ju afrua te dy zyrtareve per ti getesuar duke u thene here pas here te ulnin tonet dhe ti getesonte si dhe per ta ulur nivelin e debatit por ishte thujse e pamundur te ndalonin. Madje njeri prej dy zyrtareve (sic ju thashe dhe me lart une nuk I njoh kush jane por nga bisedat me koleget ishin Blerand Stavileci dhe Luan Maloku)ky I fundit ju drejtua kolegut ELLIN ULLGARI dhe me fjalet : "duke u betuar per femijet qe une ty sot do te rrah ose ketu ose ne hotel", kercenime qe vazhdonin”.*

Në deklaratën e tij, në cilësinë e dëshmitarit z. Izet Tahiri, ka theksuar (teksti pa ndërhyrje): *“Pasi përfundoi ndeshja isha jashtë palestrës në Vlorë duke i pritur lojtarët dhe stafin e skuadrës sonë për t’u nisur për në hotelin ku ishim të vendosur. Jashtë palestrës ishin edhe drejtuesit e KB Sigal Prishtina, Blerand Stavileci e Luan Maloku. Ndërkohë, disa minuta më pas, nga palestra dolën gjyqtarët. Për një moment, drejtuesit e Prishtinës filluan t’i akuzonin gjyqtarët për dëmtim të skuadrës së tyre. Prezent ishin gjyqtarët e ndeshjes, Xhelal Mumin e Elldin Uglari, si dhe gjyqtarët tjerë, Ngadhnjim Shabani e Artan Gashi., Debatit fillimisht nuk ishte me tone të larta, por përshkallëzoi. Kam dëgjuar fyerje në drejtim të gjyqtarëve. Kur ktheva kokën e pash që kishte një lloj tentim sulmi të drejtuesve të Prishtinës ndaj gjyqtarëve Mumini e Uglari. Menjëherë reaguam ne që ishim afër. U futëm në mes për të evituar ndonjë incident më serioz. Prezent ishte edhe Egzon Fetiu i Golden Eagle Yllit, që ndërhyri për të evituar më të keqen. Ishin po ashtu prezentë dy-tre policë, që gjithashtu reaguam. Përveç tentimeve për sulm, sharjeve dhe fyerjeve, nuk pati realizim të sulmit fizik ndaj askujt, nga ajo që kam parë unë. Kjo pati edhe ne kontribuam që mos të ketë kontakt fizik mes të përfshirëve”.*

Për me tepër z. Xhelal Mumini, variantin e tij të ngjarjes e ka treguar si vijon (teksti pa ndërhyrje): *“Pas perfundimit te ndeshjes giysmefinale te Ligës Unike ndermjet KB*

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsors:



BPJ PARASPORT VENTURE

Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsors:

Youth Basketball Supporters:





Trepça - KB Sigal Prishtina, duke u larguar nga zhveshtoret ne drejtim te hotelit, jashte para palestrës u provokuam nga personat zyrtare Blerand Stavileci dhe Luan Maloku ne drejtim te gjiqtareve e ne veçanti ne drejtim te glyqtarit Elldin Uglari. Provokimi filloj nga Blerand Stavileci ne drejtim te gjiqtarit Elldin Uglari me fjale "el kriminelo el kriminelo, ti e kryve ti mo nuk referon hajn o hajn pis qen fjale te perseritura disa here. Ne atë moment, une Xhelal Mumini, u afrova tek Blerand Stavileci per ta qetesuar dhe me nje ton te timin me agresiv duke u munduar ta ndaloj ofendimin dhe degradimin ndaj gjiqtareve dhe kolegut Elldin. Injeti (Blrend Stavileci) nuk ndalonte edhe pse tentoja ta ndaloja ofendimin e tij mirepo nuk ishte e mundur. Ne kete moment nderhyne Luan Maloku ku isha shume afer tij dhe filloj me fjale kundrejt Elldin Uglarit " pasha tre femije sonte kom me te rre, o ketu o ne hotel sonte kam me te rre" Kercënimet e Luan Malokut ndaj Uglarit ishin duke iu hasur ne drejtim te Ellin Uglarit mirepo ishte vazhdimisht i penguar nga ana ime dhe kolegeve jere, si dhe personave te ciliet ishin aty prezent anëtar te ekipeve Golden Eagle Ylli dhe Trepça ku jane munduar te ndajne, dhe aty erdhi deri te nje shtyrje mes nesh, ngritje te toneve nga ana ime (nuk e rre nuk e prek me dore".*

Gjiqtari, z. Ngadhim Shabani, variantin e tij të ngjarjes e ka përshkruar si vijon (pjesë të tekstit pa ndërhyrje): *"Pasi dolem jashte palestres, pame qe ishin pjestare nga te gjitha klubet pjesemarrese e nder ta edhe presidenti i klubit Sigal Prishtina Blerand Stavileci bashke me drejtorin Luan Maloku, ku te lartecekurit sapo na pane filluan atakimin ndaj ekipes se gjiqtareve te ndeshjes me pretendime per demtime ndaj ekipit te tyre, e qe fillimisht morën pergjegjen e kolegut Xhelal Mumini i cili u mundua te gjeje rruge komunikuese por te cilat ishin te pamundura, sepse ata filluan pastaj me ofendimet nga me te rendat ndaj kolegut Elldin Uglari, i cili veqse ishte afer vetures, por per arsye qe vetura ishte mbyllur dhe kolegu Artan Gashi kishte çelesin, nuk mundi te hyje ne veture per ti u shmangur ofendimeve, kercenimeve qe beheshin kundrejt tij. Se bashku me kolegun Artan Gashi u munduam ta pershpejtonim largimim nga aty nderkohe qe ofendimet dhe kercenimet e Blerand Stavilecit dhe Luan Malokut nuk ndaleshin, kujtoj nder disa nga ato kercenime ndaj kolegut E.Uglari si: "Ti do fshihesh dhe nuk do te referosh me asnjehere, dhe "do te rrahe nje dite e ndoshta ajo dite eshte sot kur te arrijme tek hoteli" , sepse ishim ne te njejtin hotel, e shume e shume te tjera ne prezencen e anetareve te klubeve si K.B.Trepça, K.B.Golden Eagle Ylli, K.B.Peja, anetarit te Bordit z.Egzon Fetiu, dhe erfagesuesve te Liges Unike dhe Federates Shqiptare te Basketbollit".*

Në kuadër të shqyrtimit të deklaratave, të cilat janë pjesë e dosjes së lëndës, Komisioni ka gjetur prova të mjaftueshme të cilat e konfirmojnë fakti se ndaj gjiqtarëve ka pasur shprehje të pakënaqësisë të cilat janë artikuluar me fjalë fyese, si dhe tendencë të

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





përshkallëzimit të situatës, mirëpo fatmirësisht nuk ka pasur realizim të sulmit fizik, anipse kjo nuk e arsyeton faktin e mllëfit të shprehur në formë të ofendimeve.

Ndërlidhur më frymën se Rregullores Disiplinore e cila promovon faktin se dënimet kanë karakter edukues, parandalues dhe korrigjues, dhe shqiptimi i tyre do të ketë gjithmonë qëllimin e mbrojtjes së interesit të përgjithshëm dhe vlerave të sportit të basketbollit, Komisioni ka marrë për bazë edhe rrethanat lehtësuese të cilat tregojnë se qëllimi i dënimit mund të arrihet me një dënim më të butë dhe rrjedhimisht ka marrë në konsideratë shqiptimin e një dënimi më të ulët se ai i paraparë me Rregulloren përkatëse, veçanërisht kur në rastin konkret kemi të bëjmë me individ që kanë merita për zhvillimin e sportit të basketbollit. Gjithashtu peshë në vendimmarrje ka pasur edhe fakti se nga evidencat e FBK nuk është gjetur ndonjë fakt që ndaj zyrtarëve të klubit përkatës ka pasur ndonjë rast të iniciuar për shkelje të natyrës disiplinore. Si dhe, në matje të dënimit ka marrë për bazë edhe rrethanat ndikuese të cilat lidhën më rrethanat në të cilat është kryer shkelja, sjellja e të përmendurve para dhe pas shkeljes, vetitë morale dhe qëndrimi i tyre pas veprimit të bërë.


Megjithatë, Komisioni e ka cilësuar sjelljen e zyrtarëve të Klubit të Prishtinës jo korrekte dhe jospportive e cila në çfarëdo rrethane duhet ndëshkuar në kuptimin që të inkurajohet sjellje e mirë në mënyrë që pakënaqësitë të adresohen në forma zyrtare tek organet gjegjëse të FBK-së.

Komisioni ka analizuar provat shkresore, përfshirë këtu edhe deklaratat e të përmendurve, ka ndërlidhur ato në mes veti, si dhe ka krahasuar me dispozitat e Rregullores për Procedurat Disiplinore të FBK-së dhe ka ardhur në përfundim se, z. Blerand Stavileci dhe z. Luan Maloku, si rezultat i shprehjes së mllëfit me ofendime ndaj gjyqtarëve, në rrethanat e konsideruara si më lart, kanë kryer shkelje të lehtë disiplinore dhe rrjedhimisht vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR :


Omer Daku, anëtar


Fidan Hamiti, kryetar


Afrim Kamishi, anëtar

Prishtinë, 10.05.2024

Kosovo Basketball Federation

Supported by:



General Sponsor:



Golden Sponsors:



Silver Sponsors:



Automotive Sponsor:



Youth Basketball Supporters:





Vendimi t'u dërgohet:

- Blerand Stavilecit,
- Luan Malokut,
- Gjyqtarëve të përmendur,
- Anëtarëve të Komisionit Disiplinor të FBK-së dhe
- Arkivit të FBK-së.

KËSHILLË JURIDIKE:

Konform Nenit 42 të Rregullores Disiplinore, kundër vendimit të Komisionit Disiplinor të shkallës së parë mund të parashtrohet ankesë në afat prej 3 ditë (pune), duke llogaritur nga dita e përcjelljes së vendimit përmes postës elektronike, kurse i paraqitet Komisionit të Arbitrazhit të FBK-së. Me rastin e paraqitjes së ankesës, paraqitësi duhet të paguaj në llogari të FBK taksën në shumën prej 300 €, mjete të cilat i kthehen paraqitësit nëse i miratohet ankesa.

Kosovo Basketball Federation

Supported by:

General Sponsor:



Golden Sponsors:

Silver Sponsors:

Automotive Sponsor:

Youth Basketball Supporters:

